




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.460/2022  
Datë: 24 nëntor 2022

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen 299-të, të mbajtur me datë 24 nëntor 2022, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Kandidatëve të programit Young Cell ju vazhdohet marrëdhënia e punës nga dita e përfundimit të kontratës bazë, në pozitat përkatëse, ku ushtrojnë pozitat e tyre.
- II. Autorizohet Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të ndërmerr të gjitha veprimet për nënshkrimin e kontratave.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 24 nëntor 2022.

### A r s y e t i m

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka njoftuar KGJK-në, se të punësuarve në sistemin gjyqësor përmes programit Young Cell, i financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për shkollim jashtë vendit, ju përfundon marrëdhënia e punës. Duke shtuar se pozitat në të cilat të punësuarit kanë ushtruar funksionet e tyre janë pozita të lira sipas organogramit të KGJK-së.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 24 nëntor 2022, ka shqyrtuar çështjen e vazhdimit të marrëdhënies së punës për të punësuarit përmes programit Young Cell, duke vlerësuar se të punësuarit aktual përmes këtij programi kanë dhënë kontribut të shkëlqyer në sistemin gjyqësor, prandaj, duke marr parasysh faktin se pozitat në të cilat ushtrojnë funksionet e tyre, konform njoftimit të NjMBNj, janë të lira, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.